



MUNICIPALITY OF OBILIĆ

Br. XIV-35

Data 17.03.2022

Dr.

Datum

OBILIĆ

**Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova****Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq****Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**

Komuna e Obiliqit, Drejtoria e Kulturës në bazë të rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Obiliqit si dhe në bazë të rregullores MFNR-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të, shpall:

THIRRJE PUBLIKE

I.-Për të gjithë individët, organizatat jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Obiliqit, programi i të cilave është i fokusuar në fushë veprimtaritë e kulturës, rinisë dhe sportit dhe që përfshin aktivitete të realizuara në Komunën e Obiliqit duke u bazuar në plan programin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2022 të aplikojnë për mbështetje financiare:

- **NË FUSHËN E VEPRIMTARISË SË KULTURËS, ARTIT DHE LETËRSISË/
PROMOVIMI DHE AFRMIMI I VLERAVE KULTURORE, KRIJIMEVE ARTISTIKE
DHE LETRARE**

Drejtuar	Planifikimi i aktiviteteve	Qëllimi
Organizatave kulturore që merren me veprimtari kulturore-artistike, në ruajtjen, kultivimin dhe promovimin e vlerave kulturore	Subvencionimi sipas plan-programit të organizatave	Promovimi dhe ruajtja e traditave vendore Kultivimi dhe promovimi i krijimtarisë vendore lokale; Zhvillimin e turizmit kulturor lokal; Mbështetje të aktiviteteve vjetore, blerja e kostumeve, blerja e instrumenteve
Organizatave kulturore që merren me veprimtari kulturore-artistik, në kultivimin	Subvencionimi sipas plan-programit të DKRS-së për vitin 2022:	Shënimi i datave kulturore-historike, simpoziumet dhe ekspozitat ;

dhe organizimin e aktiviteteve kulturore	<p>*Shënimi i 14 Qershorit “Qershori- muaji i krenarisë sonë”</p> <p>*Shënimi i 1 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijeve</p> <p>*Shënimi i 12 Gushtit –Ditës Ndërkombëtarë të Rinisë</p> <p>*Shënimi i 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit Kombëtar</p>	<p>Promovimi i diversitetit lokal kulturor dhe nxitja e dialogut artistik ndërkulturor ;</p> <p>Promovimi i vlerave krijuese e letrare përmes aktiviteteve të ndryshme;</p> <p>Nxitja e pjesëmarrjes së audiencave të reja në jetën kulturore</p>
Organizatave kulturore, të cilat merren me kultivimin dhe organizimin e aktiviteteve muzikore e kulturorore-artistike	<p>Subvencionimi sipas plan-programit të DKRS-së për vitin 2022:</p> <p>*Organizimi i festivaleve të këngeve e valleve – Shënimi i 14 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Komunës së Obiliqit</p> <p>*Organizimi i festivaleve të këngës e folklorit – Shënimi i aktivitetit kushtuar “Ditëve të Diasporës”</p>	<p>Nxitja e pjesëmarrjes së audiencave të reja në jetën kulturore, këndim, lojëra, skeçe humoristike;</p> <p>Promovimi i traditave përmes artit nga trashëgimia popullore;</p>
Organizatave kulturore, letrare, artit e pikturës	Subvencionimi sipas plan programit të organizatave	Mbështetje të aktiviteteve vjetore
Organizatave letrare dhe krijueseve letrar	<p>Subvencionimi sipas plan-programit të organizatave</p> <p>Subvencionimi sipas plan-programit të DKRS-së për vitin 2022:</p> <p>*Shënimi i Ditës Ndërkombëtarë të Librit</p> <p>*Organizimi i orëve dhe tryezave letrare</p>	<p>Përkrahja e krijuesve letrar</p> <p>Përkrahja e autorëve të rinjë</p>

➤ NË FUSHËN E VEPRIMTARISË RINORE DHE SPORTIVE/ PËRKRAHJA,
PROMOVIMI I SPORTIT DHE FUQIZIMI I RINISË

Drejtuar	Planifikimi i aktiviteteve	Qëllimi
<p>Klubeve, shoqateve dhe organizatave sportive të komunës së Obiliqit</p>	<p>Subvencionimi sipas plan-programit të klubeve, shoqatave dhe organizatave sportive</p>	<p>Zhvillimi dhe afirmimi i sportit në Komunën e Obiliqit Masivizimi i sportit për të rinj Mbështetja dhe përkrahja e klubeve sportive dhe sportistëve individual Ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive</p>
<p>Organizatave rinore dhe oqj-ve në komunën e Obiliqit</p>	<p>Subvencionimi sipas plan-programit të organizatave</p>	<p>Mbështetja dhe fuqizimi i organizatave rinore në zhvillimin e aktiviteteve specifike për të rinjtë që ndikojnë drejtpërsëdrejti në nxitjen e aktiviteteve në fushë veprimtaritë e çështjeve rinore, përfshirë Strategjinë Kosovare për Rini dhe Plan të Veprimit;</p>
<p>Klubeve, shoqateve dhe organizatave sportive të komunës së Obiliqit Individëve që merren me aktivitete sportive</p>	<p>Subvencionimi sipas plan-programit të DKRS-së për vitin 2022: *Organizimi tradicional i turnirit të futbollit “1 Maji” *Organizimi i maratonave, mini-maratonave, garave në sporte të ndryshme promovimi i shëndetit mendor dhe fizik “Mendja e shëndoshë në trup të shëndoshë” *Organizimi i turnirit me</p>	<p>Shënimi i datave të rëndësishme, promovimi i aktiviteteve sportive, nxitja e të rinjëve dhe të rejave për pjesëmarrje në aktivitete sportive Organizimi i aktiviteteve sportive për qëllime educative. Projekte të ndryshme me karakter sportive me grup-mosha të ndryshme</p>

	<p>vetëranët e futbollit – në shënimin e Ditëve të Diasporës, *Organizimi i streetballit – shënimi i 12 Gushtit – Ditës Ndërkombëtare të Rinisë</p>	
<p>Organizatave rinore dhe ojq-ve në komunën e Obiliqit Individëve, të rinjëve dhe të rejave që merren me çështje rinore</p>	<p>Subvencionimi sipas plan-programit të DKRS-së për vitin 2022:*Shënimi i 1 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijeve,organizimi i aktiviteteve,festivaleve, këngeve, garave në pikturë *Organizimi i tryezave/debateve, ligjeratave me temat të ndryshme: “Orientimi i të rinjëve në karrierë dhe zgjedhjen e profesionit”, “Mbrotjtja e shëndetit individual dhe grupor” –shënimi i 31 Majit Ditës Ndërkombëtare kundër Duhanit:“Luftimi i dukurive negative në shoqërin tonë” – shënimi i 26 Qershorit Ditës Ndërkombëtare kundër abuzimit me drogat “Pjesëmarrja e të rinjëve në vendimarrje dhe jetën publike” *Shënimi i 12 Gushtit – Ditës Ndërkombëtare të Rinisë *Shënimi i Javës Rinore *Shënimi i muajit Tetor- muaj i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit</p>	<p>Inkorporimin e jetës shoqërore të qytetarëve të Komunës së Obiliqit dhe në veçanti të vajzave dhe grave, duke ofruar kështu programe edukative sidomos çështjet gjinore dhe të shëndetit, si dhe pjesëmarrjes në iniciativat e ndryshme të avokimit dhe lobimit. Nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete rinore Fuqizimin dhe mbështetjen e të rinjëve të Obiliqit Mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe përfshirjen e tyre në shoqëri.</p>

II. Me vendim të kryetarit të komunës, vlerësimi i projekteve do të bëhet nga një komision profesional 3-5-anëtarësh, detyra e të cilëve është që t'i vlerësojnë projektet në bazë të kriterëve për vlerësim dhe sipas kushteteve, kriterëve dhe proceduarave të ndarjes së subvencioneve të Rregullorës MF-Nr 4/2017

VLERËSIMI DO TË BËHET SIPAS:

1. Rregullësisë dhe plotësimit të kushteve administrative të aplikimi
2. Ndërlidhjes me objektivat e thirrjes
3. Kapacitetit dhe performancës së dëshmuar organizativ dhe menaxhues
4. Vazhdimësisë së realizimit të programit dhe qëndrueshmërisë së tij
5. Njohjës ose kontributit për afirmimin ndërkombëtar të qytetit të Obiliqit
6. Cilësisë dhe përmbajtjes së projektit
7. Originalitetit të projektit

III. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve janë;

- Projekt propozimi ;
- Aplikacioni;
- Dokumenti identifikues;
- Çertifikatë e vendbanimit (për persona fizik);
- Çertifikatë e regjistrimit (për persona juridik);
- Dëshmi për pagesën e tatimit pronë (për persona fizik)
- Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik);
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;

IV. Formulari për aplikim mund të merret në zyrën pritëse si dhe mund të shkarkohet në mënyrë elektronike në ueb-faqen e komunës së Obiliqit dhe pas plotësimit dokumentacionet e kërkuara dorëzohen në zyrën pritëse, në katin e parë të objektit komunal.

V. Vlera e përgjithshme e planifikuar e thirrjes **45,000.00€ (Euro)**. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 300€ (Euro), ndërsa shuma maksimale për një projekt është **2,500.00€ (euro)**. Shuma minimale e mbështetjes financiare për OJQ-të është **2.500.00 € (Euro)**. dhe maksimale **5.500,00 €**

Vërejtje!

- Të gjithë përfituesit e mundshëm të fondeve publike-nga kjo thirrje në vazhdimësi duhet të jenë të vëmendshëm për vendimet e institucioneve shëndetësore (lokale dhe qendrore) rreth gjendjes së shëndet publik.
- Aplikacionet e arritura pas afatit nuk do të shqyrtohen, kurse dokumentacioni i pakompletuar do të refuzohet. Përfituesit e projekteve në vitin e kaluar, të cilët nuk kanë sjell raportet financiare,dhe narrative nuk do të shqyrtohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në ueb-faqën e komunës dhe në hapësirat publike në territorin e komunës së Obiliqit.

17 Mars 2022,

Obiliq

Drejtoresha e DKRS-së

